

V E N D I M

PER HEQJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : MIMOZA KAJO- BRAHIMI

Asistuar prej sekretares Suzana Murataj, në Tiranë me 19.05.2015 mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

K Ë R K U E S : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë përfaqshuar nga prokurori Endrit Bimi.

K U N D Ë R : Të dyshuarit R. S. N. ,i datëlindjes 29.04.19., lindur dhe banues në Tiranë, rruga “.....”, Pallati Nr.11, nr.... ne mungese.

A K U Z U A R P Ë R : Veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

O B J E K T I : Heqjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”, per sendin/pasurinë nr, zonë kadastrale, sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie V...., L....., J....., P....., duke urdheruar ZRPP Tirane te lejojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme juridike ne lidhje me kete pasuri.

B A Z A L I G J O R E : Nenet 274/3 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e prokurorit qe kerkoi, heqjen e sekuestros preventive per pasuritë e palujtëshme të regjistruara në emër të personit në hetim R. S. N. , mbasi shqyrtoi aktet e bisedoi çeshtjen,

V E R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar këtë procedimin penal, ne ngarkim te R. N., i dyshuar per kryerjen e vepres penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, mbi bazën e kallzimit të shtetases E. O., e cila ka kallzuar se me anë të falsifikimit të nënshkrimit të saj shtetasi R. N. ka blerë pasurinë me nr....., zonë kadastrale, sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie V....., L....., J....., P..... Ky veprim është bërë me Kontratën e Shitjes së Pasurisë të Paluajtshme, me Nr..... Rep. dhe Nr.....Kol, dt., para noterit H. Z..

Nga akti i ekspertimit nr.10, datë 17.03.2015, rezulton se kjo kontratë nuk është nënshkruar nga kallzuesja E. O., ndërsa nga akti ekspertimit Nr...../2015 ka rezultuar, që karta e identitetit me gjeneralitet e kallzuses E. O., e përdorur dhe depozituar pranë noteri është e falsifikuar.

Më pas shtetasi R. N. këtë pasuri ja ka shitur shoqërisë “.....” sh.p.k, me administratore M. Z., me aktin noteriale Kontratë Shitje të Pasurisë së Paluajtshme, me Nr..... Rep, Nr..... Kol, dt., e kryer para noterit J. Z..

Në funksion të këtij procedimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr....., dt.26.11.2014 ka vendosur masën e sigurimit pasuror sekuestro preventive, me arsyetimin se disponimi i mëtejshëm i kësaj pasurie mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale. Kështu pronarët e vërtetë të kësaj pasurie nuk mund të disponojnë në të ardhmen atë si rezultat i tjetërsimit të truallit.

Ndërkaq, rezulton se kallzuesja E. O. i është drejtuar organit të akuzës me Memo, duke kërkuar heqjen e masës së sekuestros preventive mbi këtë pasuri, pasi ka bërë me shoqërinë “A...” shpk, Akt Marreveshjen, nr.....rep,kol, dt.30.03.2015, para noterit D. G., që kjo pronë të kalojë në pronësi dhe të zhvillohet nga kjo shoqëri.

Pra tashmë kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat mbi të cilin është vendosur venia e sekuestros dhe veprimi i paligjshëm i realizuar nga R. N. është riparuar.

Neni 274 i K Pr Penale parashikon:

Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Në rastin konkret, fakti që vete kallzuesja e cila është dëmtuar nga vepra penale e kryer nga I dyshuari ka rifituar të drejtën e shkelur nga R.. N. dhe ka kërkuar heqjen e sekuestros, gjykata cmon se Kanë ndryshuar kushtet e zbatimit të sekuestros mbi pasurite e sekuestruara.

Në këto rrethana gjykata cmon si të drejtë kërkesën e prokurorit për heqjen e sekuestros dhe bazuar ne nenin 274/3 te K Pr Penale vendos heqjen e sekuestros mbi pasuritë me nr, zonë kadastrale, sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie V....., L....., J....., P....., duke urdheruar ZRPP Tirane te lejojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme juridike ne lidhje me kete pasuri

PER KETO ARESYE

Gjykata, ne mbeshtetje te neneve 274/3 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Heqjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”, per sendin/pasurinë nr, zonë kadastrale, sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie V....., L....., J....., P....., duke urdheruar ZRPP Tirane te lejojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme juridike ne lidhje me kete pasuri.

-Kundër vendimit lejohet ankim nga personat e interesuar brenda 10 ditëve nga marrja dijeni në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-U shpall sot me datë 19.05.2015.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R E

SUZANA MURATAJ

MIMOZA KAJO-BRAHIMI